


# Tregtia e jashtme e mallrave

## Mars 2017

**Tiranë, më 18 Prill 2017:** Në Mars 2017 eksportet e mallrave arritën vlerën 23 mld lekë, duke u rritur me 17,2 %, në krahasim me një vit më parë dhe me 12,9 %, në krahasim me Shkurt 2017. Importet e mallrave arritën vlerën 54 mld lekë, duke u rritur me 14,6 %, në krahasim me një vit më parë dhe me 22,3 %, në krahasim me Shkurt 2017. Deficiti tregtar i këtij muaji është 31 mld lekë, duke u rritur me 12,8 %, krahasuar me Mars 2016 dhe me 30,2 %, në krahasim me Shkurt 2017.

Fig. 1 Qarkullimi i mallrave, Mars 2015 – Mars 2017 (%)




Në tremujorin e parë eksportet e mallrave arritën vlerën 62 mld lekë, duke u rritur me 15,7 %, krahasuar me një vit më parë dhe importet e mallrave arritën vlerën 133 mld lekë, duke u rritur me 7,5 %, krahasuar me një vit më parë. Deficiti tregtar arriti vlerën 71 mld lekë, duke u rritur me 1,3 %, krahasuar me 2016.

**Ndikimi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të eksporteve:**

Rritja vjetore e eksporteve prej 17,2 %, këtë muaj është ndikuar kryesisht nga grupet: “Materiale ndërtimi dhe metale” me +9,3 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me +6,1 pikë përqindje, “Ushqim, pije, duhan” me +2,2 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të eksporteve kanë ndikuar negativisht grupet: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -0,8 pikë përqindje, “Produkte kimike dhe plastike” me -0,2 pikë përqindje, “Prodhime druri dhe letre” me -0,1 pikë përqindje.

**Fig.2 Ndikimi i grupeve në ndryshimin vjetor të eksporteve, Mars 2017**




Ekspertet, gjatë tre muajve të parë janë rritur me 15,7 %, krahasuar me një vit më parë. Grupet që kanë ndikuar pozitivisht në rritjen vjetore të eksporteve, janë: “Materiale ndërtimi dhe metale” me +6,0 pikë përqindje, “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me +5,7 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me +3,7 pikë përqindje. Grupet që kanë ndikuar negativisht në ndryshimin vjetor të eksporteve, janë: “Lëkurë dhe artikuj prej tyre” me -0,3 pikë përqindje, “Produkte kimike dhe plastike” me -0,1 pikë përqindje, “Prodhime druri dhe letre” me -0,1 pikë përqindje.

**Ndikimi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të importeve:**

Rritja vjetore e importeve prej 14,6 %, këtë muaj është ndikuar kryesisht nga grupet: “Makineri, pajisje, pjesë këmbimi” me +3,7 pikë përqindje, “Produkte kimike dhe plastike” me +3,1 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me +2,2 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të importeve ka ndikuar negativisht vetëm grupi “Prodhime druri dhe letre” me -0,1 pikë përqindje.

**Fig.3 Ndikimi i grupeve në ndryshimin vjetor të importeve, Mars2017**



Importet, gjatë tremujorit të parë, janë rritur me 7,5 %, krahasuar me një vit më parë. Grupet që kanë ndikuar pozitivisht në rritjen vjetore të eksporteve, janë: “Produkte kimike dhe plastike” me +2,5 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me +1,4 pikë përqindje, “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me 1,3 pikë përqindje. Grupi që ka ndikuar negativisht në ndryshimin vjetor të eksporteve, është: “Prodhime druri dhe letre” me -0,2 pikë përqindje.

**Ecuria e tregtisë së mallrave sipas vendeve partnere**

Në muajin Mars 2017, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me Mars 2016 janë: Italia me (13,6 %), Kosova me (24,4%) dhe Greqia me (23,5 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe janë: Franca me (-17,4 %), Kroacia me (-22,4 %) dhe Holanda me (-49,7 %).


Gjatë tre muajve të parë, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me një vit më parë, janë: Italia me (10,6 %), Kosova me (31,3 %) dhe Greqia me (17,0 %).

Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Austria me (-6,8 %), Zvicra me (26,7 %) dhe Holanda me (-19,7 %).

Në muajin Mars 2017, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me Mars 2016 janë: Italia me (20,4 %), Gjermania me (67,4 %) dhe Turqia me (15,6 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe janë: Kina me (-23,2 %), Zvicra me (-7,1 %) dhe Franca me (-27,7 %).

Në tremujorin e parë, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me një vit më parë, janë: Italia me (2,0 %), Gjermania me (36,1 %) dhe Turqia me (11,7 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Kina me (-13,4 %), Zvicra me (-1,9 %) dhe Franca me (-7,7 %).

Fig. 4 Tregtia e jashtme e mallrave sipas disa vendeve të BE-së, Mars 2017



Shkëmbimet tregtare me vendet e BE zënë 67,1 %, të gjithë tregtisë. Në Mars 2017, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 75,0 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 63,7 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (36,0 %), Gjermania (8,7 %), Greqia (7,1 %) dhe Turqia (6,3 %).

Shkëmbimet tregtare, për tremujorin e parë, me vendet e BE zënë 65,2 % të gjithë tregtisë. Në periudhën Janar – Mars 2017, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 78,5 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 59,0 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (37,8 %), Gjermania (7,5 %), Greqia (6,7 %) dhe Kina (6,6 %).

**Tab. 1 Qarkullimi i mallrave (miliardë lekë)**

Vitet	Muajt	Eksporte	Ndryshimi Vjetor	Importe	Ndryshimi Vjetor	Bilanci Tregtar	% e mbulimit
2000		37	-23,5	157	-1,5	-120	23,6
2001		44	19,1	190	21,0	-146	23,2
2002		47	7,7	210	10,6	-163	22,6
2003		54	14,7	226	7,4	-171	24,1
2004		62	14,0	236	4,5	-174	26,3
2005		66	6,0	262	11,1	-196	25,1
2006		77	17,6	299	14,1	-222	25,9
2007		97	25,5	376	25,8	-279	25,8
2008		113	15,8	440	16,9	-327	25,6
2009		105	-7,2	429	-2,5	-324	24,4
2010		162	54,6	478	11,4	-316	33,8
2011		197	21,9	544	13,9	-347	36,2
2012		213	8,2	528	-2,9	-315	40,3
2013		246	15,7	517	-2,1	-271	47,6
2014		256	3,8	552	6,7	-297	46,3
2015		243	-4,9	545	-1,4	-301	44,7
2016		243	0,1	579	6,4	-336	42,0
2014	01 - 14	18	-1,4	35	2,2	-17	51,2
	02 - 14	20	27,9	39	17,5	-19	51,8
	03 - 14	21	10,4	42	11,1	-21	50,1
	Janar – Mars 2014	59	11,6	117	10,3	-57	51,0
2015	01 - 15	18	-0,6	35	0,9	-17	50,4
	02 - 15	18	-9,4	39	-0,8	-20	47,3
	03 - 15	22	4,1	44	4,6	-22	49,9
	Janar – Mars 2015	58	-1,9	119	1,7	-60	49,2
2016	01 - 16	16	-7,8	35	-1,0	-18	47,0
	02 - 16	18	-4,4	42	7,6	-24	42,0
	03 - 16	19	-12,7	47	5,6	-28	41,2
	Janar – Mars 2016	53	-8,6	124	4,3	-70	43,1
2017	01 - 17	19	15,5	35	0,9	-16	53,8
	02 - 17	20	14,2	44	5,1	-24	45,7
	03 - 17	23	17,2	54	14,6	-31	42,2
	Janar – Mars 2017	62	15,7	133	7,5	-71	46,4

**Tab. 2 Tregtia e jashtme e mallrave sipas vendeve partnere (milionë lekë)**

	Eksporte				Importe			
	Mars-16	Mars-17	Jan.- Mar.2016	Jan.- Mar. 2017	Mars-16	Mars-17	Jan.- Mar.2016	Jan.- Mar. 2017
<b>Vendet e BE-së</b>	<b>15.844</b>	<b>17.014</b>	<b>43.122</b>	<b>48.452</b>	<b>28.092</b>	<b>34.282</b>	<b>72.646</b>	<b>78.461</b>
Austri	79	139	316	294	380	448	1.207	1.089
Mbretëri e Bashkuar	50	18	109	71	267	492	854	1.190
Gjermani	642	1.023	1.974	2.635	3.378	5.656	8.755	11.914
Greqi	877	1.083	2.341	2.739	3.838	4.365	9.581	10.372
Itali	10.684	12.133	31.783	35.154	12.789	15.400	37.730	38.494
Spanjë	246	868	1.067	2.681	1.237	1.260	2.425	2.678
Kroaci	77	60	153	151	299	324	818	905
Të tjera të BE-së	3.189	1.690	5.380	4.728	5.904	6.337	11.276	11.818
Kinë	333	978	909	2.288	4.730	3.630	12.179	10.542
Kosovë	1.376	1.712	3.126	4.104	407	740	931	1.600
Maqedonia	526	743	983	1.629	578	785	1.372	1.691
Rusi	-	-	1	6	1.285	577	2.174	1.891
SHBA	140	461	328	705	649	839	2.128	2.264
Turqi	105	203	266	482	3.978	4.600	9.745	10.889
Ukrainë	1	49	36	171	326	310	657	850
Zvicër	206	16	387	284	1.234	1.146	2.382	2.336
Të tjera	829	1.506	4.175	3.580	5.658	6.879	19.443	22.436
<b>Gjithsej</b>	<b>19.361</b>	<b>22.683</b>	<b>53.332</b>	<b>61.701</b>	<b>46.938</b>	<b>53.789</b>	<b>123.657</b>	<b>132.960</b>

**Tab. 3 Tregtia e jashtme sipas grup mallrave (milionë lekë)**

Grup-mallrat	Eksporte				Importe			
	16-Mar	17-Mar	Jan.- Mar.2016	Jan.- Mar. 2017	16-Mar	17-Mar	Jan.- Mar.2016	Jan.- Mar. 2017
<b>Gjithsej</b>	<b>19.361</b>	<b>22.683</b>	<b>53.332</b>	<b>61.701</b>	<b>46.938</b>	<b>53.789</b>	<b>123.657</b>	<b>132.960</b>
Ushqime, pije, duhan	1.583	2.003	4.707	4.844	8.386	9.084	21.972	22.942
Minerale, lëndë djegëse, en.el.	3.603	3.450	7.982	11.040	3.970	4.866	11.992	12.401
Produkte kimike dhe plastike	459	413	996	957	6.858	8.302	17.305	20.402
Lëkurë dhe artikujt prej tyre	254	252	772	635	1.217	1.316	3.399	3.572
Prodhime druri dhe letre	630	617	1.851	1.792	2.083	2.026	5.075	4.786
Tekstile dhe këpucë	8.883	10.060	26.212	28.197	6.434	7.141	17.436	19.144
Materiale ndërtimi dhe metale	2.422	4.218	6.557	9.730	6.265	7.303	15.073	15.685
Makinëri, pajisje dhe pjesë këmbimi	967	1.143	2.678	3.024	10.037	11.753	27.299	28.888
Të tjera	560	526	1.579	1.482	1.687	1.998	4.106	5.140

**Tab. 4 Eksportet sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë, (Jan.- Mar. 2016, Jan.-Mar. 2017)**

( milionë lekë)

	Itali		Kosovë		Greqi		Spanjë	
	2016	2017	2016	2017	2016	2017	2016	2017
<b>Gjithsej</b>	<b>31.783</b>	<b>35.154</b>	<b>3.126</b>	<b>4.104</b>	<b>2.341</b>	<b>2.739</b>	<b>1.067</b>	<b>2.681</b>
Ushqim, pije duhan	1.900	1.509	462	419	459	374	203	227
Minerale, lëndë djegëse, ener. elek.	607	2.921	585	1.333	97	69	256	1.922
Produkte kimike dhe plastike	381	309	302	257	63	124	0	1
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	719	494	0	-	12	17	3	4
Prodhime druri dhe letre	1.426	1.309	74	81	170	203	2	1
Tekstile dhe këpucë	21.212	22.260	11	29	1.158	1.284	489	448
Materiale ndërtimi dhe metale	2.943	3.674	1.261	1.629	286	417	106	76
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	1.876	1.906	162	128	24	157	2	0
Të tjera	718	771	269	229	72	95	6	0

**Tab. 5 Importet sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë, (Jan.- Mar. 2016, Jan.-Mar. 2017)**

( milionë lekë)

	Itali		Gjermani		Turqi		Kinë	
	2016	2017	2016	2017	2016	2017	2016	2017
<b>Gjithsej</b>	<b>37.730</b>	<b>38.494</b>	<b>8.755</b>	<b>11.914</b>	<b>9.745</b>	<b>10.889</b>	<b>12.179</b>	<b>10.542</b>
Ushqim, pije duhan	3.927	3.952	911	890	1.130	1.370	133	180
Minerale, lëndë djegëse, ener. elek.	4.160	3.839	133	157	115	276	85	1
Produkte kimike dhe plastike	3.545	4.310	1.358	1.701	1.345	1.583	923	1.044
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	2.748	2.780	1	1	75	69	192	158
Prodhime druri dhe letre	1.468	1.407	204	156	652	730	236	240
Tekstile dhe këpucë	9.127	9.556	540	540	3.122	3.459	2.081	2.450
Materiale ndërtimi dhe metale	3.905	4.044	254	1.905	1.236	1.238	3.686	1.322
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	7.748	7.328	5.089	6.163	1.654	1.675	3.990	4.090
Të tjera	1.102	1.277	265	401	416	489	852	1.055

# Përkufizime

Eksportet janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv, ose të rieksportuar pas përpunimit aktiv.

Vlera F.O.B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues, pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

Importet janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Vlera C.I.F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues, pra përfshin koston e mallit, edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat.

Nomenklatura e Kombinuar (NK) është një nomenklaturë mallrash e përdorur për statistikën e tregtisë ndërkombëtare të mallrave dhe për tarifën doganore.

<http://www.instat.gov.al/al/metodologji/klasifikime-nomenklatura.aspx>;

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian: Belgjikë, Gjermani, Francë, Itali, Luksemburg, Holandë, Mbretëria e Bashkuar, Danimarkë, Irlandë, Greqi, Spanjë, Portugali, Austri, Finlandë, Suedi, Qipro, Çeki, Estoni, Hungari, Letoni, Lituani, Maltë, Poloni, Sllovaki, Slloveni, Bullgari, Rumani, Kroaci.

## Shpjegimi i simboleve

0 vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

- pa vlerë

÷ deri